TË DREJTAT E NJERIUT

(ESE)

Esetë e përmbledhura në këtë broshurë janë shkruar nga studentët e vitit të parë të drejtimit Doganë dhe Shpedicion, të Kolegjit "Pjetër Budi", në kuadër të aktiviteteve që janë organizuar me rastin e "Muajit të të drejtave të njeriut", e që në këtë institucion është mbajtur nga data 10 dhjetor 2013 deri më 10 janar 2014.

Të kesh të drejta

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë. Për të jetuar me dinjitet, të gjitha qeniet njerëzore gëzojnë të drejtën e lirisë, të sigurisë dhe të niveleve të denja jetësore njëkohësisht - të drejtat e njeriut janë të pandashme.

AHMED OMBASHI

"Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të lindur me të drejta dhe dinjitet të barabartë". Kështu fillon Neni I Deklaratës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Të gjithë ne, sapo lindim, kemi të drejta të caktuara, të quajtura të drejta të njeriut. Thelbi i të drejtave të njeriut është dinjiteti i njeriut, pastaj e drejta e shprehjes së personalitetit, trajtimit të barabartë dhe barazisë para ligjit, liria e besimit dhe ndërgjegjes, e mendimit, shtypit, informimit dhe e mësimit, liria e mbledhjes dhe e bashkimit, zemërgjerësisë, liria e profesionit dhe e punës, pacenueshmëria e banesës, garantimi i pasurisë dhe i të drejtës së trashëgimisë, e drejta e strehimit politik dhe e peticionit, si dhe të drejtat juridike, si garanci kundër arrestimit të padrejtë, e drejta për t'u punësuar etj.

Të drejtat e njeriut janë në të njëjtën kohë edhe vlera që shprehin dhe pasqyrojnë dëshirat dhe aspiratat njerëzore. Si vlera, të drejtat e njeriut përfaqësojnë qëllimet dhe idealet më të larta, të cilat, ndonëse të parealizueshme plotësisht, i japin kuptimin jetës shoqërore.

Gjatë gjithë historisë, të drejtat e njeriut janë përcaktuar dhe kanë mëshiruar vlerën e dinjitetit të secilit, të lirisë, të barazisë dhe të drejtësisë. Këto vlera janë universale, ato dalin jashtë kornizave të kufijve personalë e kombëtarë. Kulturat dhe shoqëritë janë të ndryshme.

Po e argumentoj me një shembull të drejtën e punësimit. Para një kohe pashë një skenë që kishte ndodhur në Los Angeles të SHBA'së. Protesta para kompanisë teknologjike "Samsung", shumë njerëz e qëllonin me gurë ndërtesën, për arsye se kjo kompani gjigande punësoi vetëm punëtorë të së njëjtës fe. Protestuesit ishin të gjithë njerëz që kishin aftësi për të punuar, por feja e tyre nuk ua lejonte. Një gjë për të ardhur keq.
Shkuan disa muaj dhe kompania falimenton, për shkak të punëtorëve joprofesionistë. Këtë situatë e shfrytëzoi shumë mirë rivali "Apple", duke pranuar qindra CV - qoftë nga njerëz me ngjyrë, njerëz me fe të ndryshme, gra të mbuluara. Por, ata shikuan aftësitë dhe përvojën e tyre profesionale që do ta ngrisë kompaninë në majë, aty ku është sot dhe jo paragjykimet gjinore apo fetare.

Nëse të respektohet e drejta në punë, atëherë ti mund të jesh ai që mund ta japësh kontributin tënd për të mirën e kompanisë në bazë aftësive që ke.Njëherë e mirë duhet kuptuar se të drejtat e njeriut nuk blihen, nuk fitohen, apo nuk trashëgohen - ato u përkasin njerëzve, thjesht sepse ato janë qenie njerëzore - të drejtat e njeriut lindin bashkë me njeriun. Të drejtat e njeriut janë të njëjta për të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht nga raca, gjinia, feja, bindja politike ose nga ndonjë bindje tjetër, nga prejardhja kombëtare ose shoqërore.
Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë. Për të jetuar me dinjitet, të gjitha qeniet njerëzore gëzojnë të drejtën e lirisë, të sigurisë dhe të niveleve të denja jetësore njëkohësisht - të drejtat e njeriut janë të pandashme.

Çdo individ, pavarësisht nga prejardhja familjare, shoqërore, kulturore, gjinisë, pikëpamjeve politike apo regjionale, duhet të pranohet si përfaqësues i gjithë njerëzimit dhe të trajtohet i barabartë.
"Pa marre parasysh çfare religjioni i përket, ngjyre apo gjinie, nëse ti m'i njeh të drejtat e mira dhe je i mirë me mua, atëherë edhe unë do të jem me ty", ka thënë George Bernard Shaw.

Të shkollohesh i lirë

Ajo që nuk do të ndryshojë do të jetë lufta e parreshtur e njerëzimit për drejtësi, liri dhe dinjitet njerëzor.

DËFRIM DUSHICA

Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të lindur me të drejta dhe dinjitet të barabartë. Këto të drejta i takojnë çdonjërit dhe janë të patjetërsueshme. Ato nuk mund t'i mohohen askujt. Të drejtat e një individi janë të përhershme dhe nuk mundet askush t'i mohojë.

Njeriu si individ ka të drejtën e shprehjes së lirë, të mendojë lirshëm, të besojë në atë çfarë dëshiron, të shkollohet, të jetë i barabartë para ligjit, të jetë i lirë të informohet, të jetë i barabart në profesionin që ka.

Në botë ka shumë padrejtësi dhe diskriminim. Shumica diskriminohen shkaku i racës, port ë drejtat e njerezve shkilen në çdo hap dhe çdo ditë.

Në shumë shtete të botës ekzistojnë shumë organizata joqeveritare dhe të tjera, që përpiqen të promovojnë të drejtat e njeriut dhe të ngrenë zërin për shkeljen e tyre - sidomos në vendet që janë në tranzicion, vendet e varfëra dhe ato në zhvillim.

Para disa vitesh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në një qytet të vogël të banuar me njerëz të racës së bardhe, një familje me ngjyre kishte një djalë, i cili nuk shkonte në shkollë si çdo fëmijë. Ai dëshironte dhe kishte vullnet të madh të shkonte në shkollë, por kërcënimet dhe fyerjet që atij i bëheshin se nuk e ka vendin aty dhe se duhet të shkojë në një tjetër qytezë, ku ka njerëz si ai, shkuarjen në shkollë ia bënë të pamundur. Ishin kushtet e vështira ato që nuk lejonin ta ndërrojë vendbanimin familja e tij, ndërkohë që djalit i mohohej e drejta e shkollimit dhe në disa raste edhe e drejta e lëvizjes së lirë.

Mediat e ndryshme nga e gjithë bota i kushtuan aq shumë vëmendje këtij rasti, deri sa ndërhynë organizata të shumta joqeveritare edhe nga vendet e tjera duke i bërë thirrje shtetit dhe duke bashkëpunuar me organizatat vendëse , për të gjetur në fund një zgjidhje të përhershme për atë familje.

Nga ky rast dhe shumë të tjera, të shkeljes së të drejtave të njeriut mund të thuhet se jetojmë në një botë me shumë padrejtësi. Po ashtu, duhet të kuptojmë se njeriun nuk duhet gjykuar nga pamja e jashtme, por nga aftësitë e tij dhe puna që ai bën. Të drejtat u përkasin të gjithë individëve dhe duhet të gëzohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë. Shkelja e të drejtave të njeriut nuk nënkupton vetëm të penguarit për të realizuar një të drejtë, por nënkupton mohimin e një jete dinjitoze.

Ajo që nuk do të ndryshojë do të jetë lufta e parreshtur e njerëzimit për drejtësi, liri dhe dinjitet njerëzor. Shoqërisë i mbetet ende shumë për të bërë, që të drejtat e njeriut të respektohen në të gjitha vendet e botës. Shumë pak nga ne mendohemi ndonjëherë për mënyrën se si sillemi e flasim me njëri-tjetrin. Gjithashtu shumë pak arrijmë të shohim se në shoqërinë ku ne jetojmë ende nuk e ka arritur mirëkuptimin e nevojshëm. Jo të gjithë jemi njësoj dhe jo të gjithë tregohemi të barabartë mes të barabartëve. Kjo duhet ndryshuar.

Të paragjykosh femrën

Tani e tutje ngado sheh vullnet dhe tendencë që të kapërcehen barrierat dhe kufijtë e padukshëm diskriminues, të cilët e ngulfasin një shoqëri të shëndoshë dhe e kthejnë atë mbrapa në kohë.

VERLINDË MEMETI

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për faktin se si popull kemi rrënjë mijëravjeçare dhe nëpër etapat e jetës jemi zhvilluar, evoluar e përparuar duke u rrahur nga rryma të ndryshme qofshin ato pushtuesish, okupatorësh, uzurpuesish, luftërash, fatëkeqësish etj. Gjatë kësaj kohe, femra si qenie e butë shpirtërore dhe e pafuqishme që është, ka përjetuar gjithçka, duke mos qenë asnjëherë e vlerësuar për virtytet dhe rëndësinë e saj.

Megjithatë, ekziston një ngushëllim i lehtë për atë se çfarë ka ndodhur në të kaluarën, pasi që kudo në botë ka mbizotëruar një mentalitet i tillë. Por tani jetojmë në një kohë dinamike ku gjithçka lëviz me shpejtësinë e dritës dhe të analizojmë statusin e femrës në shoqërinë tonë është e pahijshme dhe aspak me levërdi.

Është për t'u habitur se si ende njerëzit nëse e shohin një vajzë të re duke vozitur veturën do të kenë përshtypjen sikur ajo po bën diçka të pamundur, jo për atë se vozitja është e vështirë por se si mund të ndërrojnë gjërat kaq shpejt, që ajo të dalë nga katër muret e shtëpisë dhe të kryejë punët e saj, sikur të mos i përkiste këtij realiteti. Ata nuk duan ta kuptojnë se nuk është vozitësja ajo që ka ndryshuar, por koha të cilës i përkasin.

Dalëngadalë ka filluar të instalohet një pamje moderne në përditshmërinë tonë, duke parë e dëgjuar vazhdimisht për sukseset e ndryshme të femrave shqiptare qysh nga politika, muzika e deri te sportet e ndryshme, siç është shembulli i Majlinda Kelmendit, që me xhudon e saj përveç se është shëndërruar në një simbol kombëtar, i ka tejkaluar të gjitha përmasat, duke u bërë identitet yni.

Diskriminimi pozitiv është metodë që qysh nga paslufta është përdorur në Kosovë me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve në përmirësimin e gjendjes dhe kushteve sa i përket avanicimit të gruas në shoqëri dhe jo vetëm asaj. Kjo vërehet në partitë politike ku është obligative që në listat e tyre zgjedhore çdo e treta nga të përzgjedhurit të jetë femër. Po ashtu, është e definuar me ligj përqindja e caktuar e femrave në polici, gjykata apo administratë shtetërore.

Organizata të ndryshme, qofshin ato ndërkombëtare apo vendëse mundësojnë që nëpërmjet trajnimeve të udhëzohen femrat se si të zhvillojnë bizneset e tyre private. Pra, çdo energji është e nisur drejt qëllimit madhor, të barabarësisë shoqërore në çdo aspekt.

Padyshim se kjo ka treguar rezultat duke ngjallur vetëdijen shoqërore në komunitetin që dita-ditës frymojmë. Mimoza Kusari-Lila është kryetarja e parë që do t'i prijë qytetarëve të një komune në vendin tonë. Qytetarët gradualisht kanë filluar të gjykojnë duke u bazuar jo në atë se kush e thotë, por në atë se çfarë bën.

Pothuajse në çdo komunë kemi parë femra me programe të tyre politike, duke përfaqësuar me dinjitet partitë që ua dhanë besimin për të udhëhequr.Tani e tutje ngado sheh vullnet dhe tendencë që të kapërcehen barrierat dhe kufijtë e padukshëm diskriminues, të cilët e ngulfasin një shoqëri të shëndoshë dhe e kthejnë atë mbrapa në kohë.

Disponim për ndryshim sheh kudo nëpër qarqe ku më parë as që është menduar nga vetë femrat se do t'iu vijë një ditë e tillë dhe të gjithë kanë filluar të shohin elasticitetin e mendjes si shpresë për përparim.

Edhe pse ka ende zbrazëtira të mëdha dhe duhet shumë punë për t'u bërë, themi se jemi në një rrugë të mirë, rrugë kjo që do të na qojë drejt barazisë së tërësishme shoqërore dhe të gjithë do ta ndjejmë vetën rehatshëm ashtu siç e ndjen gjithsecili veten e tij në shtëpi.

Nelson Mandela dhe kontributi i tij

"Edukimi është arma më e fortë që mund ta përdorësh për ta ndryshuar botën", thoshte Nelson Mandela.

RITA SPAHIU

Të drejtat e njeriut janë të drejta të lindura për qeniet njerëzore, pa dallime të racës, gjinisë, fesë apo kombit. Të gjithë njerëzve u takojnë të drejta të barabarta, pa diskriminin e asnjërit prej tyre.
Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e nxori dhe shpalli Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut. Në nenin 1 thuhet: "Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të lindur me të drejta dhe dinjitet të barabartë".

Pra, të drejtat e njeriut janë të garantuara me ligj, në mënyrë që askujt të mos i cënohet liria e shprehjes së mendimit, fjalës, e drejta ekonomike, politike apo sociale.

Të drejtat e njeriut nuk blihen, nuk fitohen ose nuk trashëgohen, ato u përkasin njerëzve, thjesht sepse ato janë qenie njerëzore - pra të drejtat e njeriut lindin bashkë me njeriun.
Ishte një njeri që para pak kohësh ndërroi jetë e që dha kontributin e tij të jashtëzakonshëm për të drejtat e njeriut.

Që në moshë të re ai u bë aktiv në lëvizjen e anti-aparteidit dhe iu bashkua Kongresit Kombëtar Afrikan. Pavarësisht vështirësive të mëdha, ai asnjëherë nuk ndaloi madje edhe punonte fshehurazi dhe jetonte i ndarë nga familja e tij.

Nelson Mandela u arrestua dhe doli në gjyq për aktivitetin kundër qeverisë, ai gjithmonë i mbrojti veprimet e tij si pjesë e "luftës së popullit afrikan për një shoqëri të lirë". Pas qëndrimit në burg për plot 27 vjet ai u lirua dhe më 1994 u bë presidenti i parë me ngjyrë i Afrikës së jugut, në moshën 75 vjeçare.

Duke qenë një udhëheqës i jashtëzakonshëm ai e çliroi vendin nga dhuna e urrejtja dhe e shndërroi në një vend me më shumë paqe dhe mirëkuptim.

Mandela u nderua me dhjetëra çmime e mirënjohjes, mes tyre edhe me Nobelin për Paqe. Mandela nga shumë njerëz cilësohej si njeri i thjeshtë dhe që kujdesej për të tjerët. Ai iu përkushtua kryesisht mobilizimit të afrikanëve për të punuar për zhvillimin ekonomik e për të pasur një arsimim të mirë.
Ai ka dhënë një mesazh të qartë për të gjithë njerëzit anembanë botës, duke besuar të ndikojë në vendet ku të drejtat e njeriut cenohen ende.

Në varrimin e tij morën pjesë përfaqësues nga nëntëdhjetë e një shtete të botës e mijëra qytetarë. "Edukimi është arma më e fortë që mund ta përdorësh për ta ndryshuar botën", thoshte ai. "Në jetë, e rëndësishme është se sa ke mundur të ndikosh në jetën e të tjerëve", përsëriste shpesh.

unialo! Ke Nako!

Të diskriminosh tjetrin

Sikur të gjithë njerëzit të ishin modestë aq sa janë injorues, do të kishim jetuar pa frikë dhe me shumë qetësi.

VALON NEZIRI

"Mos fol ti","ku din ti", "nuk mund tq shkosh nq shkollë", "zezak" janë disa fjalë e fjali të cilat dëgjohen shumë në jetën e përditshme. Çdo njeri që në momentin e lindjes së tij gëzon të drejtën "me jetu", pavarësisht moshës, racës, gjinisë apo edhe fesë.

Sot bëhen shumë padrejtësi ndaj shumë personave të moshave të ndryshme - sidomos fëmijëve. Ata nuk munden as të flasin, as të shprehen, as të veprojnë siç ata mendojnë, madje nuk munden as të shkollohen.

Shumë fëmijëve nuk u lejohet shkollimi dhe ndaj tyre ushtrohet diskriminim i vrazhdë nga persona të ndryshëm, të pandërgjegjshëm. Ata detyrohen të punojnë punë të rënda fizike, por edhe në rrugë. Shumë fëmijë madje janë lypsarë dhe viktima të dhunës që ushtrohet mbi ta, në mënyrë që të punojnë për persona që i keqtrajtojnë.
Shumë nxënës e student nuk munden as të shkollohen, disa nga frika se fyhen vetëm pse janë me ngjyrë, e disa të tjerëve (vajzave) u ndalohet kjo e drejtë ngase janë të mbuluara.

Si mund të zhvillohet një shtet demokratik kur nuk u lejon vajzave të mbuluara shkollimin dhe nuk parandalon dhe ndëshkon fyerjet racore? Si të mund të shkojë në shkollë një vajzë me ngjyrë dhe e mbuluar? Këto dhe shumë pyetje të tjera do të duhej të kishin përgjigje deri sot, por që fatkeqësisht nuk ndodh kështu.

Të gjithë jemi njerëz, të gjithë kemi të drejta të barabarta pavarësisht moshës, gjinisë, fesë apo racës. Sikur të gjithë njerëzit të ishin modestë aq sa janë injorues, do të kishim jetuar pa frikë dhe me shumë qetësi.


ALL
HUMAN
BEINGS
ARE BORN FREE AND
EQUAL IN DIGNITY
AND RIGHTS
THEY ARE ENDOWED WITH
REASON AND CONSCIENCE
AND SHOULD ACT
TOWARDS ONE ANOTHER
IN A SPIRIT
OF BROTHERHOOD

T'i shkelësh të drejtat e njeriut: Rasti i Kosovës

Respektimi i të drejtave të njeriut përveç që është normë legale dhe obligative për institucione, është edhe vlerë e shoqërisë sonë.

VALDET SPAHIU

Të gjithë ne, që kur lindim, kemi të drejta të caktuara të quajtura të drejtat e njeriut. Këto të drejta i takojnë çdonjërit dhe janë të patjetërsueshme, dmth. ato nuk mund t'i mohohen askujt. Sot në shumë vende të botës shkilen të drejtat e njeriut, sidomos në vendet e varfëra. Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e nxori dhe shpalli Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut. Në Nenin 1 të saj thuhet: "Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të lindur me të drejta dhe dinjitet të barabartë".
Pra, të drejtat e njeriut janë të garantuara me ligj dhe në këtë mënyrë askujt nuk duhet t'i cenohet liria e fjalës, shprehjes së mendimit, e drejta ekonomike, politike etj.

Shpesh në media lexojmë për vendet afrikane, aziatike dhe të Amerikës Latine ku shkelën të drejtat e njeriut. Ndërkohë nëse i referohemi periudhës para vitit 1999, edhe në vendin tonë ka pasur shkelje të të drejtave te njeriut. Si pasojë e luftës që u zbatua nga formacionet ushtarako-policore dhe paramilitare serbe, u vranë, masakruan, zhdukën, dhunuan, dëbuan dhe deportuan qindra-mijëra vetë.
Përveç masakrave në njerëz u plaçkitën, dogjën dhe u rrënuan shtëpitë, objektet fetare, shkollore, kulturore, ekonomike, si dhe vendbanime të tëra shqiptare, me synim spastrimin etnik, gjë që e vështirësoi edhe më shumë jetën e njerëzve.

Bërja publike e këtyre shkeljeve të të drejtave të njeriut, këtyre shifrave është një detyrim moral ndaj viktimave dhe familjarëve të tyre. Mirëpo institucionet përkatëse, të cilat duhet të merren me shifra dhe hulumtime të ndryshme, nuk janë edhe aq të angazhuara, e njësoj vepron edhe shoqëria civile, që shpeshherë është edhe e manipuluar nga vetq pushteti.

Sa i përket opinionit ndërkombëtar, ai është shumë pak i informuar mbi krimet gjenocidale që janë ushtruar mbi popullsinë shqiptare.

Ndërkaq, Qeveria e Kosovës duhet të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ta vendosë demokracinë, qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, si dhe të angazhohet në maksimum për arritjen e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Respektimi i të drejtave të njeriut përveç që është normë legale dhe obligative për institucione, është edhe vlerë e shoqërisë sonë.

Të mos shijosh fëmijërinë

Fëmijët shndërrohen në mbajtës të familjes dhe rrezikojnë shëndetin dhe ardhmërinë e tyre, nuk kanë një arsim cilësor dhe kushte për shkollim.

VALENTINA BOBAJ

Ideja e të drejtave të njeriut dhe e lirive njrëzore është shumë e vjetër. Për liritë dhe të drejtat e njeriut është menduar në të gjitha epokat e zhvillimit të shoqërisë. Në disa shoqëri mesjetare, e drejta e njeriut përcaktohej si e drejtë natyrore. Askush nuk mund t'ia mohonte njeriut të drejtat, madje as mbreti, pavarësisht se sa fuqi kishte ai.

Të drejtat e njeriut ndryshonin varësisht prej sistemeve shoqërore politike, nëpër të cilat kalonte njerzimi. Me vite të tëra të drejtat e njeriut kanë qenë të shkelura mizorisht. Këto shkelje ishin rezultat i padrejtësisë, diskriminimit dhe paragjykimit ndaj popujve të ndryshëm.

Pa liri, pa barazi jeta vazhdonte të ishte e ashpër dhe tepër e vështirë. Drejtësia nevojitej të mbronte çdo njeri dhe të vendosej rend dhe rregull në shoqëri.Por, edhe sot po vazhdojnë të shkilen të drejtat, sidomos tek fëmijët të cilët detyrohen të punojnë.

Këta fëmijë duhet të ishin duke shijuar jetën, e jo të shfrytëzohen si fuqi punëtore, e disa të tjerë të shesin cigare nëpër kafeteri dhe në rrugë, për të fituar bukën e gojës. Më ndodh çdo ditë të shoh fëmijë që kërkojnë lëmoshë: "Më jepni ca para, ju lutem", "Zoti ju ndihmoftë".

Fëmijët për shkaqe ekonomike detyrohen të braktisin mësimin dhe të punojnë punë të rënda, punë këto të ndaluara me të gjitha konventat për të drejtat e fëmijëve. Fëmijët shndërrohen në mbajtës të familjes dhe rrezikojnë shëndetin dhe ardhmërinë e tyre, nuk kanë një arsim cilësor dhe kushte për shkollim. Për këtë arsye them se fëmijët në Kosovë kanë një ardhmëri shumë të pasigurt.

Organizata vendëse e ndërkombëtare në Kosovë janë angazhuar dhe angazhohen vazhdimisht të zhgjidhin probleme që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.Për t'i kuptuar më lehtë të drejtat e njeriut, ato janë ndarë në katë grupe kryesore: të drejtat elementare personale, të drejtat civile dhe politike, të drejtat sociale dhe ekonomike dhe të drejtat për ambientin.

E drejta personale është e drejtë për jetën. Për të jetuar njeriu duhet të jetë i lirë, të shprehet lirisht, të lëvizë lirisht, të krijojë marrëdhënie pune etj.

Të drejtat civile dhe politike iu takojn përsonave mbi moshën 18 vjeçare, të cilët e kanë të drejtën e votës e zgjedhjes së lirë.Në të drejtat sociale dhe ekonomike hyjnë të drejtat sociale, të drejtat pë mbrojtjen shëndetësore etj. Këto të drejta ndryshe quhen të drejtat e brezit të dytë.

Të drejtat për ambientin quhen të drejtat të brezit të tretë dhe funksioni i tyre është mbrojtja e natyrës.

Kolegji "Pjetër Budi"

Prishtinë

Shkurt 2014